

VENDIM
Nr. 60, datë 23.1.2013

**PËR RRRITJEN E KUOTËS SË ANËTARËSIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË FONDIN
MONETAR NDËRKOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1, 2, 3 e 4 të ligjit nr. 7515, datë 1.10.1991 “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investimet” dhe të nenit 3 të ligjit nr. 105/2012 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e neneve të marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN)”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 105/2012 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e neneve të marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN)”, rritet për shumën 79.3 (shtatëdhjetë e nëntë pikë tre) milionë SDR.

2. Autorizohet Banka e Shqipërisë të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin e shtesës së kuotës së anëtarësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha